



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 3938 prot.

Berat , më 28.07. 2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe “Mbi miratimin e strehimit në banesat sociale me qira”

KRYETARI

Ervin DEMO

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuçi, Drejtor i , Emergjencave ,Pronave dhe Transportit

Konceptoi: Meleq Spahiu ,Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE, PRONAVE DHE TRANSPORTIT

RELACION

MBI MIRATIMIN E STREHIMIT NË BANESAT SOCIALE ME QIRA

Te nderuar Keshilltare !

Komisioni i Strehimit i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.52, datë 28.01.2020 , mbledhur më datë 15.06.2021, mori në shqyrtim kërkesat e aplikantëve, për strehim në banesat sociale, me qëllim strehimin e njërit prej tyre , në apartamentit me nr.4,kati i parë ,banesa sociale nr.1 .

Në këtë apartament me Vendimin të Këshillit Bashkiak nr.38,datë 29.07.2011,ishte strehuar deri tani familja e znj.Jeta Ymeri i cili e dorëzoi apartamentin për arsye personale .

Mbështetur në kërkesat e qytetareve që kanë aplikuar për t'u strehuar në banesat sociale si dhe në sistemin e pikëzimit të miratuar me vkb në të cilin merret parasysh për cdo aplikantë ,kushtet e strehimit, kushtet familjare , kushtet sociale si dhe kushtet ekonomike, komisioni mori ne shqyrtim kërkesat nga vendosi ti propozojë për miratim Këshillit Bashkiak :

1. Strehimin familjar të znj. Arjana Xheladini në apartamentin nr.4, me strukturë 1dhomë+1kuzhinë, kati i pare ,banesa sociale nr.1, me përbërje familjare dy persona ,vet PAK dhe djali në moshë madhore , duke dorëzuar apartamentin garsonierë nr.1 , banesa sociale nr.1.
2. Strehimin znj.Kozeta Greku në apartamentin garsoniere nr.1, banesa sociale nr.1, me përberje familjare një person me ardhura mujore vetëm nga përkrahja sociale.

Drejtor i E.P.T
Erlin Kuçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2021

MBI MIRATIMIN E STREHIMIT NË BANESAT SOCIALE ME QIRA

Kryetari i Bashkisë mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8/2 , neni 24/2, neni 9 pika 1.1 gërma “b”, neni 64 gërma “c” ; ligjin nr. 22/2018 “ Për strehimin social “ i ndryshuar , VKM nr.384,datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore “ dhe Vendimit të Komisionit të Strehimit të datës 15.06.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Të strehojë familjen e znj. Arjana Xheladini në apartamentin nr.4, me strukturë 1dhomë + 1 kuzhinë, kati i parë , banesa sociale nr.1 , apartament i liruar nga znj.Jeta Ymeri.
2. Të strehojë znj. Kozeta Greku në apartamentin nr.1, me strukturë garsonir , kati i parë , banesa sociale nr.1 , apartament i liruar nga znj. Arjana Xheladini.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave, Pronave dhe Transportit.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prot. 8937
dt: 28.07.2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues " Mbi miratimin e kërkesës së Bashkisë Berat, së bashku me dokumentacionintekniko- ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Petrit Brahimaj banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri , nga buxheti i bashkise dhe buxheti i vitit 2021 në ministrinë e mbrojtjes , programi " emergjencat civile "

KRYETARI

Ervin DEMO

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuçi,: Drejtor i Emergjencave Civile ,Pronave ,Transportit dhe Sherbimeve

Konceptoi:

Hajrie Mbrati Specialist i Emergjencave Civile

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA E EMERGJENCEVE CIVILE TRANSPORTIT DHE PRONAVE

RELACION

“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET BANESAT E TË CILËVE JANE DËMTUAR NGA ZJARRI, NGA BUXHETI I BASHKISË I VITIT 2021, PROGRAMI “ EMERGJENCAT CIVILE “

Te nderuar keshilltare,

Ne daten 22.05.2021 nga zjarri u demtua 1 banes ne Bashkine Berat .

Pas arkivimit te kerkes se shtetasit Petrit Brahimaj dt.24.05.2021, banor I Lagjes 1, Lagja 30 Vjetori , Komisioni i Emergjenceve i ngritur me urdherat Nr. 284 date 26.05.2021 te Kryetarit te Bashkise , shkoi ne vendngjarje dhe ne baze te konstatimit fizik , hartoi proces verbalin e demeve te shkaktuara, mbeshtetur ne VKM Nr.329, date 16.05.2012 “Per kriteret per procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore “

Proces verbali i konstatimit u percolle ne Keshillin e Qarkut me shkresat Nr. 2851 Prot, date 31.05.2021 per vleresimin e demeve sipas ligjit.

Komisioni i Eksperteve te Keshillit te Qarkut,ka perfunduar vleresimin e demeve te shkaktuara ne banesen e z. Petrit Brahimaj jane percjelle ne Bashkine Berat me Nr. 330/1 Prot , date 29.06..2021 Ne mbeshtetje te preventivave te hartuara nga grupi i eksperteve derguar ne Bashkine Berat rezultojne demet :

a. Punime ndertimore	367 051	leke
b. Orendi dhe pajisje	87 700	leke
Totali	454 751	leke

Bazuar ne dokumentacionin qe disponojme , ne VKM Nr.329 date 16.05.2012 shkronjen “ç”, te pikes 1, te kreut III; i propozojme Keshillit Bashkiak te miratoje vleren e ndihmes se menjehereshme financiare per:

Z. P[etrit Brahimaj ne vleren 227 375 leke

Ndihma financiare do te perballohet nga fondet e emergjences se Bashkise per sigurimin e jetes dhe kushteve te perkoheshme te jeteses , si dhe per shpenzime te tjera per perballimin situates emergjente .

DREJTORI DECTP

Erlin Kuçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVEKNDIM

Nr. _____, datë _____ 2021

“ MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONINTEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN EZ PETRIT BRAHIMAJ BANESA E TË CILIT ESHTË DËMTUAR NGA ZJARRI , NGA BUXHETI I BASHKISE DHE BUXHETI I VITIT 2021 NË MINISTRINË E MBROJTJES , PROGRAMI “ EMERGJENCAT CIVILE “

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , Ligjin nr. 8756, date 26.03.2001 “ Per Emergjencat Civile “ i ndryshuar dhe VKM nr. 329 date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore “: me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Te miratojë kërkesën e Bashkisë Berat për mbështetje financiare të shtetasit Petrit Brahimaj per demtimin e baneses nga zjarri i rënë në datat 22.05.2021
2. Te miratoje dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Berat.
3. T'i akordojë si ndihmë emergjente nga buxheti i Bashkise Berat, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkisë për vitin 2021, familjes së shtetasit
 - Petrit Brahimaj ne vleren 227 375 (dyqindeenjezeteeshtatemijeetreqindeeshtatedhjetepese) leke .
4. Ndhma financiare për familjen e shtetasit Petrit Brahimaj përcaktohet sipas kriterëve të VKM nr. 329, datë 16.05.2012.
5. Ndhma financiare që do te akordohet do të perdoret per t'i ardhur në ndihmë familjeve të shtetasit Petrit Brahimaj banesa e të cilit eshte dëmtuar nga rënia e zjarrit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës , Drejtoria Emergjencave Civile Pronave Transportit dhe Sherbimeve.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca